STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 4 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON PERPARIM NE PROGRAMIN E RESTAURIMIT TE PLAZHIT

Përpjekjet e përshpejtuara të restaurimit synojnë plazhin dhe zonat bregdetare të dëmtuara nga super stuhia Sendi (Sandy)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se një përpjekje e përshpejtuar për të restauruar plazhet e dëmtuara nga super stuhia Sendi (Sandy) dhe për të mbrojtur pronat nga stuhi të ardhshme do të fillojë me dhënien e tenderave në mars për punën e restaurimit që pritet të fillojë në prill në Stejtën Ajlënd (Staten Island). Puna e restaurimit do të shtrihet në zona të tjera bregdetare në rajonin e Qytetit të Nju Jorkut (New York City) dhe Long Ajlënd (Long Island).

"Udhëzova agjencitë shtetërore, përfshirë DHSES dhe DEC, që të punojnë me homologët e tyre federalë dhe vendorë për t'a bërë restaurimin e plazhit dhe bregdetit një përparësi në përpjekjet tona për të mbrojtur dhe siguruar vijën tonë bregdetare të prekshme dhe lagjet e banueshme aty pranë," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Rimëkëmbja nga Sendi (Sandy), rindërtimi i komuniteteve tona, mbrojtja e shtetasve tanë dhe forcimi i pengesave tona natyrore bregdetare duhet të bëhet në një mënyrë të zgjuar dhe të bashkërenduar. Kjo punë gjithashtu duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, duke siguruar se rindërtojmë në mënyrë më të zgjuar dhe më të fortë."

Përpjekja e restaurimit të plazhit, e udhëhequr nga Shteti i Nju Jorkut (State of New York), ka përfshirë takime të përjavëshme me Korpusin e Inxhinierëve të Ushtrisë së SHBA-së (U.S. Army Corps of Engineers), zyrën e Kryetarit Blumbërg (Bloomberg), DEC, DHSES dhe FEMA. Departamenti i Parqeve i Qytetit të Nju Jorkut (New York City Parks Department) është gati që të bëjë tenderin për projektin e Stejtën Ajlënd (Staten Island) si një masë mbrojtëse urgjente.

Shteti bashkërendoi seanca mbi sferën e restaurimit me partnerët e tij vendorë dhe federalë për zonat bregdetare në Stejtën Ajlënd (Staten Island) që ishin më të prekshme pas super stuhisë Sendi (Sandy). Kjo përpjekje e bashkërenduar do të nxisë gjithashtu dhëniet e përshpejtuara të lejeve për projektet e Korpusit të Ushtrisë (Army Corp) të planifikuara për Koni Ajlënd (Coney Island) dhe Rokëuejs (Rockaways), të planifikuara për të filluar përpara verës.

Të paktën 75 përqind e financimit për punën e restaurimit të Stejtën Ajlënd (Staten Island) do të vijë nga programi i Ndihmës Publike i FEMA. Me kërkesën e Shtetit, FEMA do të përshpejtojë detyrimin e këtyre fondeve.

Përfaqësuesi i SHBA Majkëll Grim (Michael Grimm) tha, "Përpara sesa super stuhia Sendi (Sandy) të shkatërronte Stejtën Ajlënd (Staten Island), i kam bërë thirrje Korpusit (Corps) që të përfundojë studimin e tij të bregdetit dhe të fillojë fortifikimin e vijës tonë bregdetare të prekshme. Tani nevoja është shumë me urgjente, gjë që ua kam shprehur zyrtarëve shtetërorë, vendorë dhe federalë në raste të shumta. Falënderoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) që dëgjoi shqetësimet tona dhe që e njohu këtë nevojë urgjente. Udhëheqja e tij në këtë përpjekje do të na lejojë të veprojmë shpejt për të restauruar plazhet tona, duke i bërë ato më të forta dhe të pajisura më mirë për të parandaluar përmbytjen dhe për t'u qëndruar stuhive të ardhshme."

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418